



## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike e ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” për licencim në veprimtarinë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.
2. Mbi lenien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE.
3. Mbi lenien në fuqi të vendimit nr. 199, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE.
4. Mbi lenien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE.
5. Mbi lenien në fuqi të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetë vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a..
7. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 201, datë 03.09.2018, për miratimin e “Planit të masave për operatorin e shpërndarjes të energjisë elektrike ‘OSHEE’ sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”.
8. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit.
9. Mbi miratimin e udhëzimit për procedurat dhe afatet e kryerjes së monitorimeve nga Enti Rregullator i Energjisë.
10. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit.